

PROCEDURA E APLIKIMIT PËR NJË DOKUMENT ARKIVOR GJYQËSOR

Në mbështetje të VKM Nr. 252, datë 29.04.2022, “Për procedurat e ofrimit të Shërbimeve *ON-LINE* nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, **shërbimi i dërgimit dhe/apo studimit të çfarëdo dokumenti arkivor gjyqësor kryhet vetëm nëpërmjet platformës e-albania.**

ASNJË KËRKESË NUK PRANOHET ME POSTË APO PERSONALISHT PRANË NESH.

Hapni linkun www.e-albania.al, përdorni butoni Hyr, më pas zgjidhni opsionin si qytetar, vendosni numrin personal të ID dhe fjalëkalimin për të aksesuar profilin tuaj.

Klikoni tek Shërbime me titullin: “*Aplikim online për dokumente arkivore gjyqësore nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor*”.

➤ *Klikoni opsionin Përdor*

Zgjidhni llojin e aplikimit: Zgjidhni opsionin - Njohje pronësie/trashëgimie; Birësim, Njohje atësie; Penale;

Lidhja e kërkesës me paditësin: Zgjidhni opsionin - Vetë personi; I ati/e ëma; Gjyshe; Katragjyshe; Trashëgimtar tjetër;

Të dhënat e dosjes gjyqësore - Plotësoni vendet bosh:

Numri i vendimit..... Data, muaji, viti Gjykata.....

KUJDES: Nëse nuk keni lidhje të qartë me dokumentin gjyqësor që kërkon, **DUHET** të bashkëlidhni dokumentin që vërteton lidhjen ligjore.

si trashëgimtar - **Certifikatë trangu familjar dhe Certifikatë vdekje e paraardhësit;** ose

si përfaqësues ligjor – **Prokurë të Posaçme;** ose

në rast të fitimit të pronësisë me blerje - **Kontratë shitje-blerje** me subjektin palë në procesin gjyqësor, dokumentacionin e të cilit kërkon të aksesoni; ose

në rast regjistrimi prone të paluajtshme – **Shkresë nga ASHK vendore** që përcakton nevojën e aksesit të një dosje gjyqësore;

➤ *Klikoni opsionin Dërgo.*

Pas marrjes së kërkesës online, pas verifikimit përkatës për dokumentin dhe lidhjen ligjore në platformën e-albania ju ngarkohet fatura e pagesës.

Subjekti kërkuar shkarkon faturën dhe kryen pagesën në çdo dege bankë. [Tarifa e shërbimit është 1500 leke plus 200 lekë x çdo akt nga dosja gjyqësore nëse i takon dhe ekziston pranë nesh].

Pasi kërkuar ngarkon konfirmimin bankar për kryerjen e pagesës në aplikimin e kryer, ASHSGJ i vë në dispozicion kërkuar dokumentin arkivor gjyqësor të kërkuar në format digjital me nënshkrim elektronik brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.

NËSE nga verifikimi i kryer: a. dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar **NUK** gjendet; apo b. dokumenti që vërteton lidhjen ligjore me të **NUK** bashkëlidhet në aplikim; **ASHSGJ** saktëson në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen e mosngarkimit të aktit/dokumentit gjyqësor të kërkuar si dhe adreson subjektin ku ta kërkojë dokumentin.

NËSE konfirmimi bankar për kryerjen e pagesës **NUK** bashkëlidhet në aplikim, **ASHSGJ REFUZON OFRIMIN E SHËRBIMIT** duke saktësuar në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen.

DREJTORI

Dr. Alfred Çausi

